



## NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e premte, në datën 01 dhjetor 2017, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

<b>Gentian Sami</b>	<b>SALA NEZAJ</b>	<b>Kryetar Zëvendëskryetar</b>
<b>Agron Gledis</b>	<b>GJEKMARKAJ GJIPALI</b>	<b>Anëtar Anëtar</b>
<b>Piro Suela</b>	<b>MISHA MUSTA</b>	<b>Anëtar Anëtar</b>
<b>Zylyftar</b>	<b>BREGU</b>	<b>Anëtar</b>

AMA, pasi mori në shqyrtim çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. Miratimin e vendimit “Mbi përcaktimin e pagesave për licencë/autorizim dhe shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive”. **(Vendimi nr. 220, datë 01.12.2017);**
2. Miratimin e vendimit “Për çeljen e garës për dhënien e licencës komëtare të transmetimit audio analoge dhe miratimin e dokumentacionit të licencimit”. **(Vendimi nr. 221, datë 01.12.2017);**
3. Kalimin e të drejtave të licencës së subjektit audioviziv privat vendor “TV Adriamed” në shoqërinë “RTV ADRIA-MED”, zëvendësimin dhe rinovimin e licencës së shoqërisë “RTV ADRIA MED” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat vendor “TV Adriamed”. **(Vendimi nr. 222, datë 01.12.2017);**
4. Zëvendësimin dhe rinovimin e licencës së shoqërisë “6+1 Vlorë” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat vendor “Tv 6+1”, me licencë për transmetime audiovizive. **(Vendimi nr. 222, datë 01.12.2017);**
5. Rinovimin e licencës së shoqërisë “F.K.T.” sh.p.k., për subjektin audio privat vendor “Radio Vlorë”, për një periudhë 5 vjeçare”. **(Vendimi nr. 223, datë 01.12.2017);**
6. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Radio Sport” sh.p.k., si dhe ndryshimin e emërimit të subjektit audio nga “Radio Sport” në “Radio Shqip”. **(Vendimi nr. 224, datë 01.12.2017);**
7. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “Top Channel” sh.a., duke vendosur ndryshimin e emrit të shërbimit të programit audioviziv nga “MusicAl” në “Melody.TV”. **(Vendimi nr. 225, datë 01.12.2017);**
8. Rrëzimin e aplikimit dhe mosdhënien e autorizimit, subjektit person fizik Albi Malasi, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor “Algen Net”. **(Vendimi nr. 226, datë 01.12.2017).**

Po ashtu, AMA, pasi shqyrtoi projektvendimin “Për miratimin e Kodit të Transmetimit për median audiovizive”, ra dakord t’a shtyjë vendimmarrjen për në mbledhjes e tij të radhës.

Tiranë, 01 Dhjetor 2017

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**